

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti për Krime të Rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj kryetar, Luan Berisha e Nazim Vllaqo anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Birsën Kume, duke vendosur në lëndën penale ndaj të akuzuarit P. B. nga Prizreni, për shkak të veprave penale marrja e ryshfetit nga neni 343 paragrafi 1 të KPK-së, ushtrimi i ndikimit nga neni 345 paragrafi 1 të KPK-së dhe falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.3409/11-II e datës 17.03.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datën 07.12.2016 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësit Av.A. J. , murr dhe publikisht shpall këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari:

P. B. nga i ati P. , e ëma R. , e lindur N. , i lindur më në Shëngjin-Mirditë, Republika e Shqipërisë, tani me banim në Prizren në Rr. ” LA/2 nr.18, instruktor në Auto shkollën “ ” me seli në Prizren, i martuar, i ati i 4 fëmijëve, ka të kryer fakultetin letërsi gjuhë shqipe, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar – shtetas i R. Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

I.

Në mbështetje të nenit 364 pika 1.3 të KPP-së.

### LIROHET NGA AKUZA

Se gjatë periodës kohore shkurt-prill të vitit 2011 në Prizren si instruktor në auto shkollën “ ” kërkon përfitim të një përparësie të padrejtë për vete në lidhje me ushtrimin e ndikimit të pa duhur nga ana e kryerësit mbi vendimmarrje të personit zyrtarë, në atë mënyrë që nga kandidatët të cilët janë nënshtruar marrjes së patent shoferit ka marr të holla në shuma të ndryshme, duke premtuar kandidatët se dhënien e testeve e kanë të siguruar përmes ekzaminerit në Ministrinë e transportit dhe telekomunikacionit ashtu që nga kandidati V. V. KK Dragash, ka marr shumën prej 400 eurove, nga kandidati F. G. nga fshati . KK Prizren, ka marr 350 euro, me datën 22.02.2011 nga kandidati N. Sh. ka kërkuar dhe ka marr shumën prej 500 eurove, me datën 30.03.2011 nga kandidati A. lidhur me klientin e një kandidati kërkon 650 euro, me datën 07.04.2011 nga personi i quajtur F. lidhur me kalimin e dy kandidatëve kërkon shumën prej 850 euro.

Këso dore do të kryente veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 paragrafi 1 të KPK-së.

- Për shkak se nuk është provuar që i akuzuari të ketë kryer këtë vepër penale.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## II.

### REFUZOHET AKUZA

Sepse gjatë periodës kohore shkurt-prill të vitit 2011 në Prizren përpilon dokument të falsifikuar certifikatën mjekësore për kandidatët të cilët nënshtrohen provimit për patent shofer nga Ordinanca mjekësore Dr. R A , pastaj kandidatët të ndryshëm certifikatën e mjekut e përdorin gjatë dhënies së provimit për marrjen e patent shoferit.

- Këso dore kishte për të kryer veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së.

Për shkak të tërheqjes së prokurorit të çështjes nga akuza.

## III.

### ËSHTË FAJTORË

Sepse me datë shkurt-prill të vitit 2011 në Prizren si instruktor në auto shkollën " " duke ushtruar detyrën tejkalon kompetencat me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore kërkon dhe merr para për vete për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtar të cilën ai nuk duhet të kryej në atë mënyrë që nga kandidatët të cilët janë nënshtuar marrjes së patent shoferit ka marr të holla në shuma të ndryshme duke premtuar kandidatët se dhënien e testeve e kanë të siguruar ashtu që nga kandidati V. V. KK Dragash ka marr shumën prej 400 eurove, nga kandidati F. G. nga fshati KK Prizen ka marr 350 euro, me dt.22.02.2011 nga kandidati N. Sh ka kërkuar dhe ka marr shumën prej 500 euro, me datë 30.03.2011 nga kandidati A lidhur me kalimin e një kandidati kërkon 650 euro, me dt.07.04.2011 nga personi i quajtur F. lidhur me kalimin e dy )kandidatëve kërkon shumën prej 850 euro, gjithsejtë ka 19 (nëntëmbëdhjetë) telefonata në periodën kohore shkurt-mars-prill të vitit 2011 me kërkesë për para prej kandidatëve të ndryshëm të cilët janë nënshtuar testit për patent shofer në pjesën teorike dhe praktike.

-Këso dore ka kryer veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 343 paragrafi 1 të KPK-së.

Gjykata në kuptim të dispozitave së lartshënuara dhe neneve: 3,6,11,34,36,38,64 dhe neni 343 par.1 të KPK, të akuzuarin e:

### G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 19.05.2011 deri me datën 11.07.2011.

Obligohet i akuzuari P. B që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj paushallin në lartësi prej 200 (dyqind) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur akuzë PP.nr.3409/11-II e datës 17.03.2014 kundër të akuzuarve R. Th. M. A. P. B. I. G. dhe J. B. për shkak të veprave penale marrja e ryshfetit nga neni 343 paragrafi 1 të KPK-së, ushtrimi i ndikimit nga neni 345 paragrafi 1 të KPK-së dhe falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së.

Sa i përket të akuzuarit P. B. është veçuar procedura me aktvendimin e kësaj gjykate P.nr.66/2014 të datës 09.11.2015 ndërsa për të akuzuarit tjerë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë gjykata ka marr aktgjykimin P.nr.66/2014 të datës 09.11.2015 me të cilin ka përfunduar çështja penale ndaj tyre i cili aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datë 21.12.2015.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka qëndruar në tërësi si në aktakuzën e ngritur kundër të akuzuarit P. B. për shkak të veprave penale marrja e ryshfetit nga neni 343 paragrafi 1 të KP-së, ushtrimi i ndikimit nga neni 345 paragrafi 1 të KP-së. Meqenëse gjatë provave të administruara, dëgjimit të dëshmitarëve N. M. M. Th dhe T. C. në bazë të transkripteve është konstatuar se i akuzuari në periudhën kohore shkurt-prill të vitit 2011 në cilësinë e personit zyrtarë –instructor në auto shkollën “ ” duke ushtruar detyrën ka tejkaluar kompetencat me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, kërkon dhe pranon para për vete për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim të cilin ai nuk do të kryej në atë mënyrë që kandidatët që janë nënshtruar marrjes së patent shoferit, ka marrë të holla në shuma të ndryshme gjë që është vërtetuar edhe nga transkriptet e bisedave, ku në asnjë bisedë që ka zhvilluar nuk ka prova që ka kërkuar para sipas tarifës për kandidatët të cilët është dashtë të nënshtrohen për patent shofer në pjesën teorike dhe praktike, por gjithnjë shumat i ka kërkuar paraprakisht dhe jo në zyrën ku ka auto shkolla “ ” selinë, por takimet i ka lënë nëpër lokale duke bashkëpunuar.

Andaj, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 paragrafi 1 të KP-së, pasi që është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin nën I të akuzës, po ashtu gjatë periudhës kohore shkurt –prill 2011 si instructor në auto shkollën “ ” kërkon një përfitim të një përparësie të padrejtë për vete në lidhje me ushtrimin në ndikimin nga ana e kryerësit mbi vendim marrjen e personit zyrtar, ashtu që nga kandidatët të cilët janë nënshtruar marrjen e patent shoferit ka marr të holla në shuma të ndryshme, duke premtuar se dhënien e testeve e kanë të siguar pasi qëndron në raporte të mira me ekzaminier gjë që është vërtetuar në tërësi nga transkriptet e bisedave dhe raportet që ka pasu me ekzaminier nga Prizreni dhe Prishtina. Kështu që në veprimet e të akuzuarit formohen elementet e veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 345 paragrafi 1 të KP-së.

Andaj, ka propozuar që të akuzuarin ta shpalli fajtor për këto dy vepra penale dhe të dënojë sipas ligjit. Ndërsa për veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KP-së, është tërhequr nga akuza me që nga provat e administruara nuk është provuar vepra penale në fjalë.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokati A. J. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se gjatë zhvillimit të procedurës penale në bazë të provave të administruara dhe vlerësimit të tyre kundër të mbrojturit të tij, ndaj mendimin se aktakuza nuk është provuar dhe nuk qëndron ashtu siç është përcaktuar në dispozitivet e aktakuzës. Fillimisht vlen të theksuar se këtu i akuzuari P. B. në auto shkollën “ ” në Prizren ka ushtruar detyrën e instructorit, instructor i cili

nuk kanë drejtë të nënshkruaj dhe të vendos për asgjë, andaj parashtrahet pyetja se si i njëjti a është person zyrtarë a jo, dhe sipas qëndrimit të mbrojtjes ai nuk është person zyrtarë. Vlen të theksohet se një dispozitivin nën I të aktakuzës ceket se gjatë periudhës kohore shkurt prill 2011 në cilësinë e personit zyrtarë instruktor në autoshkollën “ ” tejkalon kompetencat, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, kërkon dhe merr para për vete për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtarë të cilin ai nuk duhet ta kryej në mënyrë që nga kandidatët të cilët janë nënshtruar marrjes së patent shoferit, ka marr të holla në shuma të ndryshme, duke premtuar kandidatët se dhënien e testeve e kanë të siguruar ashtu që nga kandidati V. V. KK Dragash ka marr shumën prej 400 euro, kandidati F. G nga fshati Billushë KK Prizren ka marr 350 euro, me datë 25.02.2011 nga kandidati N. Sh lidhur me kalimin e një kandidati dhe marr shumën prej 500 euro, me datë 30.03.2011 nga kandidati A. lidhur me kalimin e një kandidati kërkon 650 euro, me datë 07.04.2011 nga personi i quajtur F lidhur me kalimin e dy kandidatëve kërkon 850 euro.

Në seancën e mbajtur me datë 15.06.2016 janë marr në pyetje N. M cili deklaron se V. V nuk ka qenë i kënaqur me auto shkollën “ ” ku ka qenë i regjistruar, andaj ka kaluar edhe është regjistruar në auto shkollën “ ” ku ka bërë orë shtesë po ashtu edhe F. G. P ka marr pasi janë regjistruar dhe kanë bërë orë shtesë për ndryshe kur nuk ka biseduar me të akuzuarin për kalimin e ndonjë kandidati. Në seancën e datës 19.09.2016 janë dëgjuar dëshmitarët G dhe M. Th dhe nga deklarimi i G rrjedhë se nuk qëndron ajo që G ti ketë dhënë para të akuzuarit për kalimin e djalit të tij M i cili ka bërë orë shtesë për të kaluar më lehtë, përndryshe emri i dëshmitarit M G si kandidatë as që nuk përmendet në aktakuzës. Dëshmitari T. C në deklaratën e tij të dhënë me dt.26.10.2016 ka deklaruar se nuk e njeh të akuzuarin se djali i tij quhet F dhe kur me të akuzuarin nuk ka biseduar aq më tepër ti ketë dhënë para për kalimin e djalit, po ashtu edhe emri i F nuk figuron në akuzë. Dëshmitari M. B. mohon të ketë biseduar me të akuzuarin për me kalu ndonjë kandidatë. Po ashtu as me provat tjera të administruara posaçërisht me dëgjimin e bisedave telefonike të zhvilluara që i akuzuari të ketë biseduar dhe marr të holla nga dikush për kalimin e kandidatëve të auto shkollës të përmendur në dispozitiv të aktakuzës. Assesi nuk mund të vërtetohet se për të cilin kandidatë janë kërkuar të holla, ato biseda qartë bijën ndesh me deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar në seancat e lartcekura.

Sa i përket veprës penale në pikën II të aktakuzës, veprës penale falsifikimi i dokumentit, me asnjë provë të administruar nuk është vërtetuar se i akuzuari P. B. ka kryer çfarëdo veprimi rreth falsifikimit të dokumentit zyrtarë, gjatë gjithë procedurës as që fare nuk na është ofruar ndonjë provë e dokumentit të falsifikuar. Sa i përket veprës penale ushtrimi i ndikimit, për këtë veprë penale parashihet dënim burgimi deri në 2 vjet burgim e pasi që nga koha kur dyshohet se është kryer vepra kanë kaluar 5 vite dhe konsiderojmë se konform nenit 90 par.6 lidhur me nenin 91 par.6 e njëjta është parashkruar. Me të cekurat më lartë ka propozuar që i akuzuari P. B në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPK të lirohet nga akuza për veprat të cilat ngarkohet në aktakuzë.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesorë i ka nxjerrë të gjitha provat e nevojshme dhe pas administrimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave në tërësi ka vërtetuar;

Sa i përket veprës penale ushtrimi i ndikimit gjykata ka konstatuar se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë.

Sa i përket veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, gjykata ka marrë aktgjykim refuzues për shkak se prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka hequr dorë nga ndjekja.

Sa i përket veprës penale marrje e ryshfetit nga neni 343 par. 1 të KPK-së, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari me datë shkurt-prill të vitit 2011 në Prizren si instruktor në auto shkollën " " duke ushtruar detyrën tejkalon kompetencat me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore kërkon dhe merr para për vete për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtar të cilën ai nuk duhet të kryej në atë mënyrë që nga kandidatët të cilët janë nënshtruar marrjes së patent shoferit ka marr të holla në shuma të ndryshme duke premtuar kandidatët se dhënien e testeve e kanë të siguar ashtu që nga kandidati V. V. KK Dragash ka marr shumën prej 400 eurove, nga kandidati F. G nga fshati Billushë KK Prizen ka marr 350 euro, me dt.22.02.2011 nga kandidati N. Sh. ka kërkuar dhe ka marr shumën prej 500 euro, me datë 30.03.2011 nga kandidati A. lidhur me kalimin e një kandidati kërkon 650 euro, me dt.07.04.2011 nga personi i quajtur F. lidhur me kalimin e dy )kandidatëve kërkon shumën prej 850 euro, gjithsejtë ka 19 (nëntëmbëdhjetë) telefonata në periodën kohore shkurt-mars-prill të vitit 2011 me kërkesë për para prej kandidatëve të ndryshëm të cilët janë nënshtruar testit për patentë shofer në pjesën teorike dhe praktike.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata ka dëgjuar dëshmitarët N. M. G. Th. M. Th. , T. C. dhe M. B. dhe me pajtimin e palëve gjykata ka bërë leximin e shkresave: si leximi i urdhëresës së Gjykatës Pmdr.nr.11/2011 të dt.17.05.2011 në lokacionin auto shkollë , leximi në vërtetimin mbi hyrjen në banesë dhe lokale dhe lokale tjera në objektin e auto shakollës me dt.19.05.2011, leximi në procesverbalin mbi bastisjen e banesës dhe personave të dt.19.05.2011, leximi në 4 (katër) vërtetime mbi marrjen e përkohshme të sendeve në auto shkollën të dt.19.05.2011, leximi i urdhëresës së Gjykatës Hep.nr.81/2011 të dt.11.07.2011 përkitazi me ekzaminimin e një shtëpize të kompjuterit dhe një lap top të auto shkollës , lrximi në vërtetimin mbi kthimin e gjësendeve me nr. të raastit 2011-XI-04 të dt.09.08.2011 me nr. të gjësendeve prej D1 deri D6 pronë e auto shkollës , leximi në vërtetimin mbi kthimin e gjësendeve pronë e auto shkollës Geni me nr. D1 deri D të dt.07.07.2011, leximi në raportin e bastisjes dhe foto albumin në auto shkollën në Prizren dhe i banesës në lagjen Ortakoll rr. , shikimi në fotodokumentacionin e dt.19.05.2011 me nr. të dosjes së Forenzikës TKA-026-11, shikim në fotografit e 2 (dy) librave-ditareve dhe përmbajtjes së tyre në auto shkollën , shikimi i ditarit të pjesës teorike me mbishkrimin nga 9 faqe e do në 9 faqe e gjysmë, regjistrimi i kandidatëve për shofer dhe lëshimi i vërtetimeve me mbishkrime nga 17 faqe e gjysmë, foto libri me gjithsej 30 fotografi, leximi në dëshminë e dt.03.06.2011 me nr. të dosjes së hetimit , D2, leximi në listën e Ministrisë së transportit dhe pos telekomunikacionit njësia për patent shoferë në Prizren, lista nr.94/T/11 B të dt.30.03.2011, lista nr.119/T/11 B e dt.21.04.2011, leximi në regjistrin amzë i kandidatëve të aftësuar nga ndihma e parë për patentë shofer organizata komunale në Prizren nr. i listës , evidenca e vijimit të kursit të ndihmës së parë Kryqi i Kuq i Kosovës – OK Prizren dt.15-16.04.2011 dhe leximi i vërtetimit të lëshuar nga Ministrisë e Transportit dhe Post Telekomunikacioni me nr. dhe vërtetimi me nr.6-304. Kontrata e punës për kohë caktuar e lidhur me datën 01.10.2012 në mes të auto shkollës " " dhe të akuzuarit P. B. Çertifikata e regjistrimit me numër të biznesit numër fiskal auto shkollë " ". Vërtetimi i lëshuar nga MTPT nr. . Vërtetimi i MTPT nr. , Kontrata e punës e lidhur me datë 06.09.2010 në mes të auto shkollës " " si punëdhënës dhe P. B

I akuzuari P. B në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit kryesorë ka deklaruar se nga viti 2005 e dri në vitin 2010 ka punuar si instruktor i praktikës në auto shkollën , ndërsa që nga dt.01.10.2010 ka filluar të punon si instruktor i praktikës dhe i teorisë në auto shkollën . ku

pronar i asaj auto shkolle ka qenë D. C. D., ndërsa P. B. ka qenë punëtor me kontrat, dhe se i njëti në zyre nuk ka punuar por ka punuar vetëm në teren, ndërsa prej dt.10.10.2015 e deri në ditën e sotme punon në auto shkollën C Sh.p.k dhe i njëjti është pronar i kësaj auto shkolle dhe është i licencuar nga Ministria e Transportit. I akuzuari ka deklaruar se kandidati për tu regjistruar në auto shkollë duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, të jetë i moshës 18 vjeq, duhet të jetë i shëndosh fizikisht dhe psiqikisht dhe duhet të pajiset me qertifikatën e ndihmës së parë. I akuzuari në vazhdim ka deklarua se kandidati i cili është i regjistruar në auto shkollën e cila është në regjionin e Prizrenit, atëherë ai duhet të parqet testin në Prizren.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit se gjatë dëgjimit të CD-së së përgjimeve i akuzuari në bisedat telefonike ka përmendur numrat 5, 2.5, i akuzuari në përgjigjen e kësaj pyetje ka deklaruar se ata numra kanë qenë tarifatat për kandidatët të cilët kanë regjistruar orë teorike dhe praktike. Në vazhdim i akuzuari ka deklaruar se kandidati përmes auto shkollës duhet ti plotësoj këto dokumente si vërtetimin e orëve, kategorinë e orëve, fletëparaqitjen, certifikatën e mjekut etj. I akuzuari ka deklaruar se e njëjti K. i cili ka punuar si ekzaminer por ka mohuar se është takuar ndonjëherë me të njëtin në qebaptoren Sarajeva, po ashtu i akuzuari ka deklaruar se i njëjti edhe ekzaminerët nga Prishtina të cilët janë përmendur gjatë një bisede telefonike në mes të akuzuarit me një person. I akuzuari po ashtu ka deklaruar se e njëjti edhe N. M. dhe se njihet me të për një kohë të gjatë dhe mohon të ketë bashkëpunuar me të, vetëm se ai i ka sjellë disa kandidat për tu regjistruar në auto shkollën dhe për këtë gjë ai nuk i ka kërkuar të ketë ndonjë përfitim për vete. Ndërsa kandidaten me emrin Mi' ka mohuar se e njëjti dhe nuk iu është kujtuar.

Dhe në funde i akuzuari ka deklaruar se në aktakuzë është i akuzuar si i dyshuar për periudhën kohore, shkurt - prill 2011, ndërsa prokurori gjatë tërë kohës i është referuar për periudha tjera kohore, dhe konsideron se asnjë provë nuk e mbështet dyshimin se ka kryer vepra penale për të cilat akuzohet dhe se qëndron në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi i tij av. A. J.

Gjykata duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit të njëjtës pjesërisht ia fali besimin dhe atë sa i përket veprës penale të ushtrimit të ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK ndërsa nuk ia fali besimin sa i përket veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.1 të KPK kjo për faktin se mbrojtja e të akuzuarit sa i përket kësaj vepre penale është dhënë në drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale, kjo argumentohet edhe me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga të cilat është vërtetuar se i akuzuari ka qenë person zyrtarë në organizatën e biznesit respektivisht auto shkollën " " gjithashtu vërtetohet edhe nga telefonatat të cilat i akuzuari i ka pasur me personat e ndryshëm të përmendur edhe në dispozitivin e përshkrimi nga të cilët ka kërkuar shumat të caktuara të hollave për marrjen e patent shoferit.

Dëshmitari N. M. ka deklaruar se e njohë P. B. rreth 10 apo 12 vite, ndërsa ai personalisht nuk ka punuar në asnjë auto shkollë private e as në auto shkollën e shtetit. Dëshmitari ka deklaruar se i ka ndihmuar P. B. për ti siguruar kandidatë të cilët kanë pasur nevojë të regjistrohen në auto shkollë dhe të aftësohen për marrjen e patentë shoferit. Gjithashtu ka deklaruar se e njëjti V. V nga fsh. dhe se ai i ka kërkuar ndihmë sepse në auto shkollën të cilën e kishte regjistruar nuk ishte i kënaqur, ka dashur të bën orë shtesë si në teori po edhe në praktik dhe për këtë e kishte njoftuar me P. B. për të regjistruar tek auto shkolla C dhe nuk i kujtohet se sa para i kishte kërkuar P. B. për ta regjistruar si kandidat në auto shkollën e tij.

Gjithashtu ka deklaruar se e njohë edhe F. G. nga fsh. ku edhe këtë e ka njoftuar me P. B. për ta regjistruar auto shkollën se edhe F. G. ka kërkuar të bën

orë shtesë që të përgatitet për marrjen e patentë shoferit dhe këto biseda janë zhvilluar më shumë në zyrën e auto shkollës dhe për këtë F. i ka dhënë parat P. por nuk i kujtohet se sa ka qenë shumta e parave, vetëm se i kujtohet se kandidati ka kërkuar orë shtesë. Dëshmitari ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë përfitim për vete nga kjo, vetëm se i ka ndihmuar P. B. për ti siguruar kandidatë nga se e kishte shokë P. dhe se i njëjti ia ka mundësuar kandidatëve që pagesën ta bëjnë me rata-këste, nëse ata nuk kanë pasur mundësi me bë pagesën e auto shkollës menjëherë. Dhe kandidatet të cilët kanë bërë orë shtesë tek auto shkolla, kanë qenë të kënaqur dhe e kanë dhënë testin për patentë shofer.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit N. M. gjykata pjesërisht ia fali besimin. Në të vërtetë gjykata i besoi këtë dëshmitari vetëm në pjesën ku i bëri deklaron se i ka gjetur kandidat për marrjen e patent shoferit të akuzuarit P. B., ndërsa nuk ia fali besimin dëshmisë së tij ku i njëjti ka deklaruar se këta kandidat kanë kërkuar të bëjnë orë shtesë në tek i akuzuari P. B. ngase po këta kandidat kanë qenë të regjistruar në autoshkolla tjera siç e thot edhe vet dëshmitari.

Dëshmitari G. Th., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se P. B. e ka pa për herë të parë kur e ka regjistruar djalin e tij në auto shkollën C., dhe se i ka paguar shumën prej 500 euro dhe kjo shumë ka qenë për ti kryer të gjitha shërbimet e nevojshme për kandidatin dhe po ashtu këtu kanë qenë të llogaritura edhe orët shtesë të cilat i kishte bërë djali i tij M. Th. sepse ai vet ka kërkuar që djali i tij të bëjë orë shtesë për vozitje sepse ai punon si vullkanizer dhe vozit veturën e firmës dhe ka përgjegjësi për këtë.

Dëshmitari ka deklaruar se shumë e parave ja ka dhënë dy herë nga gjysma P. B., gjysmën e parave ja ka dhënë në fillim kur e ka regjistruar djalin e tij në auto shkollë ndërsa gjysma tjetër nuk i kujtohet se kur ja ka dhënë, dhe se këto para ja ka dhënë në zyrë të auto shkollës C., dhe nuk i kujtohet se sa ka qenë tarifa e orëve shtesë të cilat i ka kërkuar ti bëjë dajli i tij. Po ashtu dëshmitari ka deklarua se dokumentacioni e ka kompletuar P. B., por djali i tij i ka kryer të gjitha kontrollat mjekësore, sepse pa qenë djali vet aty ato dokumente nuk mundet mi marr. Dhe ka deklaruar se me P. ka kontaktuar përmes telefonit, për ta pyetur se kur ka me hy djali i ti në test dhe e ka pyetur se a e ka dhënë testin a po jo djali i tij.

Dëshmisës së dëshmitarit G. Th. gjykata ia fali besimin përveq në pjesën ku i njëjti deklaron se vet ka kërkuar që djali i tij M. Th. të bëjë orë shtesë e që është në kundërshtim me vet dëshminë e tij, ku vet dëshmitari deklaron se i ka paguar shumën prej 500 eurove për regjistrim në Autoskollën C. ku ka qenë instruktor P. B. gjë të cilën e konfirmon edhe dëshmitari M. Th. djali i dëshmitarit G. Th. i cili ka deklaruar se paratë të akuzuarit P. B. ia kishte dhënë babai i tij G. Th.

Dëshmitari M. Th., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se auto shkollën për aftësimin e patentë shoferit e ka regjistruar në auto shkollën C., dhe aty e ka njohur P. B. si instruktor i asaj auto shkolle, dhe se ka qenë me babanë e tij kur ka shkuar në auto shkollën për tu regjistruar si kandidat. Dëshmitari ka deklaruar se nuk i kujtohet sa orë ka bërë shtesë por e dinë se ka bërë orë ekstra, se babi i tij kishte kërkuar që aji të bëjë orë shtesë për tu aftësuar më mirë. Gjithashtu dëshmitari ka deklaruar se ai nuk i ka dhënë para P. B., por parat ia kishte dhënë babai i tij dhe se nuk e din se sa para ja kishte dhënë për këtë. Po ashtu dëshmitari ka deklaruar se të gjitha certifikata e nevojshme për paraqitjen e patentë shoferit i ka marrë vet, pasi është kontrolluar nga mjeku. Dëshmitari ka deklaruar se ka ushtruar 2 javë me instruktorin e tij P. B., i cili e ka përgatitur dhe e ka mësuar se si duhet të plotësuar testi me shkrim, për dhënien e patente shoferit me shkrim, po ashtu në vazhdim ka deklaruar se në atë

kompjuterit LG Alfa tek, një urdhër për shfrytëzimin e automjetit zyrtarë, libri i punës, urdhëresat e punës, raporti i testit praktik , diplomë M. B. , 59 dëftesa, një sim kartel AMC, një CD, një certifikatë, një vërtetim QPS, një kopje letërnjoftimit F: Q: , një kontrate qiraje, numri i llogarisë BPB, lista e kandidatëve, numri i llogarisë bankare Banka Ekonomike, vendim autorizim i datës 07.01.2006, certifikatë e gjykatës , fletëpagesa, fletore, librezë kursimesh, kartonë të kandidatëve, dorëshkrime, llogaria bankare Raifaisen bank, llogaria bankare NLB, dëftesa të plotësuara, urdhëresa të punës, ditare të pjesës teorike, dokumentacion i kandidatëve, dokumentacion i instruktorëve.

Nga urdhëresa e kësaj gjykate Hep.nr.81/2011 të datës 11.07.2011 vërtetohet se kjo gjykatë ka lëshuar urdhëresë për ekzaminimin e shtëpizës së kompjuterit dhe një llap topi të auto shkollës “ ”.

Nga raporti i bastisjes dhe foto albumi i auto shkollës “ ” në Prizren dhe i banesës në lagjen “Ortakoll” rruga “ ” kati nr. si dhe foto dokumentacioni i datës 19.05.2011 vërtetohet se në këto lokacione është bërë kontrolli bazuar në urdhëresën e lëshuar nga gjykata me ç rast është bërë kontrollimi i gjithë dokumentacioneve të auto shkollës dhe këto dokumentacione janë evidentuar me numrat e caktuar, gjithashtu nga foto dokumentacioni shihen objektet-lokalet të cilat janë shfrytëzuar nga auto shkolla “ ” hapësirat e brendshme respektivisht zyrat dhe klasat ku janë mbajtur ligjëratat e kandidatëve po ashtu shihen edhe dokumentacionet e fotografuara nga ana e policisë.

Nga vërtetimi mbi kthimin e gjësendeve të pronës së auto shkollës “ ” të datës 07.07.2011 vërtetohet se janë kthyer libri i regjistrimit të kandidateve, ditari i pjesës teorike, libreza e kandidatit I. S. dhe dosja e kandidatit R. S.

Nga vërtetimi mbi kthimin e gjësendeve i datës 12.07.2011 vërtetohet se auto shkollës “ ” janë kthyer një telefon mobil “Samsung” një sim kartelë Vala dhe një sim kartelë Ipko.

Nga vërtetimi mbi kthimin e gjësendeve i datës 09.08.2011 vërtetohet se auto shkollës “ ” i janë kthyer një leje e punës, një certifikatë e regjistrimit, certifikata e numrit fiskal, numri i biznesit, 18 –liçenca dhe dokumente shtesë të personelit të auto shkollës dhe 14 urdhëresa të punës dhe blloqe të dëftesave.

Gjykata ka bërë dëgjimin e bisedave telefonike të cilat kanë qenë të regjistruara në CD-në e përgjimeve, e cila ka qenë provë në aktakuzë.

Biseda e zhvilluar me dt.10.03.2011 ora 18:39:36 sek. me nr. kontaktues me nr. Y njofton P për një kandidate se ka ardhë dhe po pyet a i kryen për qatë qmim te dyjat teorin dhe praktikën, P i thotë jo ska shacë për me i kry, për ty te dyjat teorin dhe praktikën 322 euro, 250 euro ja 50 euro praktika dhe paraqitja 11 euro për dy provimet dhe pa fitim vetëm për ata (ekzaminerët).

Biseda e zhvilluar me dt.10.03.2011 ora 16:16:13 sek. me nr. kontaktues me nr. Pjetri i përgjigjet personit se nuk dëgjohet, personi me nr. e lartcekur e pyet, kamë një kandidat për test teorik sa mundesh me kry për mua, P përgjigjet me 250 euro.

Biseda e zhvilluar me dt.16.03.2011 ora 14:09:26 sek. me nr. kontaktues me nr. Personi me nr. e lartcekur e pyet P se a mundet me kry një kandidate në vozitje, P thotë po, po duhet gjanat, personi kërkon me ditë se sa duhet me kry, P i thotë ajt se vij aty edhe të tregoj.



Biseda e zhvilluar me dt.21.03.2011 ora 08:07:24 sek. me nr. kontaktues me nr. 044-286-023. Personi me nr. të lartcekur i thotë P mirëmëngjes, P i thot mirë është puna, personi e pyet se kush po vjen, anakonda a..., P i thot po por mes ban za aty s..., personi i thot a atij ja dhe dyrek a, pjetri i thot qke ti u kry ajo punë, personi i thot epo mos tja baj gajle te zhdukem prej këtu mos te rri ksajde fort, P i thot hajt mos ja baj gajle mos fol me kënd.

Biseda e zhvilluar me dt.21.03.2011 ora 10:07:59 sek. me nr. kontaktues me nr. Personi i thotë P, H në ora 11:00 e paska a mundesh me ja q uni selam, P i thot se Po.

Biseda e zhvilluar me dt.23.03.2011 ora 14:09:57 sek. me nr. kontaktues me nr. P i thot personit me nr. të lartcekur, a ke dal a jo, personi i thotë P E ka dal po tash po tash rezultatin pe presim, P e pyet se a i ka plotësua ai krejt, personi i thot se ai po thot po, ha fol, P e pyet a a në rregull, E fol në telefon dhe i thot he baci P; P e pyet se a i ka plotësue ai ate, E i thot urdhëro, P e pyet se a ti ka plotësu letrat, E i thot po po i ka plotësue, P i thot hajt okej qao, E i thot tash ta kqyrim kur të delin rezultatet, P i thot ajt rri qaty kur del rezultati prit. Tung.

Biseda e zhvilluar me dt.24.03.2011 ora 09:26:30 sek. me nr. kontaktues me nr. Personi i thotë P mirdita i nderum N jam, dhe vazhdon tu i thënë ej P kqyre bre një vozitje sot e kamë a mundesh me kry a jo ti jap 50 euro hajde po takohemi edhe ti jap qato 50 euro ok kur të afrohem ta baj një telefon, P i thot mirë në rregull.

Biseda e zhvilluar me dt.24.03.2011 ora 11:53:19 sek. me nr. kontaktues me nr. Personi me nr. të lart cekur i thotë P, po a të duhen lekët a dhe se të vynë, P thot nja 600 (gjashtëqind) më duhen, personi i thot 600 (gjashtëqind) sdi a mundem po pe thiri gazdën dhe M nsae mujn i tubojn, P i thot kqyre se kam dhe të tjer dhe skam mundësi me i mbulu. Ok tung.

Biseda e zhvilluar me dt.24.03.2011 ora 18:05:58 sek. me nr. kontaktues me nr. Personi me nr. të lartcekur i përgjigjet duke i thënë urdhëro P, P i thot se e krewa ata unë, personi i thotë P: mir e paske hjek qafesh a tu lajmrun ata 3.5 për të dy apo edhe për vozitje, P i thot 3 (tre) mi kadhanë ai tjeti e ka me tre apo me gjashtë se ka si i Suharekës me duket ok tung.

Biseda e zhvilluar me dt.29.03.2011 ora 21:30:40 sek. me nr. kontaktues me nr. N bisedon me telefon me P dhe bisedojn lidhur me një kandidate. N bisedon me telefon me P dhe bisedojn lidhur me një kandidate, N i thot P se a mundet me ja kry deri me të 14.04.2011 vetëm testin, P i kërkon 500 euro për me ja kry deri me 14.04.2011, P thotë N që me ja kry të gjitha teori e praktik i kërkon 650 euro dhe ja kryn në Prishtin të gjitha.

Biseda e zhvilluar me dt.30.03.2011 ora 09:32:05 sek. me nr. kontaktues me nr. A bisedon me P B lidhur me një kandidat, A ja jep numrin e telefonit të një kandidati P dhe i thotë që të takohet me kandidatin te Abi, A i thotë P se ka biseduar me kandidati n që ai të paguaj 650 euro për marrjen e patent shoferit por prap do mirren vesh me kandidatin.

Biseda e zhvilluar me dt.30.03.2011 ora 09:33:55 sek. me nr. kontaktues me nr. P. e thir kandidatën që e mer nr. e telefonit nga A dhe F me anë të telefonit len takim me kandidatën NN që të takohen te Abi.

Biseda e zhvilluar me dt.30.03.2011 ora 12:35:02 sek. me nr. kontaktues me nr. Personi e kontakton në telefon P. B. dhe i thot se është duke ardhur për Prizren, po ni A. M. në ora 13:00 a mundesh mem ba najsen, P. E. përsërit emrin A. M. dhe i thot u krye.

Biseda e zhvilluar me dt.31.03.2011 ora 16:11:05 sek. me nr. kontaktues me nr. N. i thotë P. hej edhe për atë që të thash e din atë natë, ai është duke menduar se qka me ba, ai që ja dham dy varianta a po kupton a jo, P. i përgjigjet se po, N. i tregon se dy varjantat të cilat ja dham për ktu edhe atje larg, thot sa i ka treguar atë dit dhe i japish 300 copa përpara edhe tjerat a është qeshtu a jo, pjetri i thot mir mir.

Biseda e zhvilluar me dt.05.04.2011 ora 10:13:20 sek. me nr. kontaktues me nr. Personi me nr. të lartcekure telefonon P. dhe i thot se a mundesh me ba ti dishka kësi pashoshe të shqipërisë dhe letërnjoftimin e kam për një jaran, P. gjatë kësaj bisede të përgjuar nuk është ndëgjuar se qka ka folur vetë se biseda ka vazhduar e personit i cili i thot se ky paska gjete ndjenin ja paska lyp 2800 euro tha se kam një shok e qata thash të pyes ty, dhe ndëgjohet duke i thënë qajo qajo qaty është puna, u kry nuk është problem.

Biseda e zhvilluar me dt.14.04.2011 ora 13:50:42 sek. me nr. kontaktues me nr. P. kontakton në telefon me F. e pyet se si kalon, F. i thot se jam në vozitje qitu, ndërsa P. i thot se është me V. dhe se V. i ka thënë që paraqitjen ta bënë F., F. i thot po 11 njëmbëdhjetshen, P. i thot po kurse 50 ky, F. thot se 50 e ka dhe tash takohemi.

Biseda e zhvilluar me dt.17.04.2011 ora 11:50:45 sek. me nr. kontaktues me nr. Personi NN e pyet P. se sa është B, P. thotë 5, ndërsa personi NN F. i thot se për mu a del naj sen, P. i thotë se te 5 del një 50 she, dhe personi i thot F. se ti duet me ja kry krey ta dish, P. i thot se gjitha i ky un po kryqin e kuq jo.

Biseda e zhvilluar me dt.17.04.2011 ora 22:06:02 sek. me nr. kontaktues me nr. F. e thëret P. në telefon dhe i thot, unë fola me prind dhe po tërehekt motra se shtrejt për motrën 450, edhe për mua po thonj se është pakës shtrejt, e tash nëse mundesh diqka ma lirë, une po i hikësaj pune, e dij se ke shumë shpenzime ti e di se ke shumë pun me ngajt, edhe pom vjen keq që herën e kalme nuk kemi krye mpun, nëse mundesh diqka më lir, e qeto 100 euro që i ka ka me ti dhan ty, psh nëse i thom na, A. dhe do me than qerat ma tepër se 100 ershit me na ybrit pak me tepër, me ul qmimin edhe me hy unë kismet prej të hanës, P. i thot une ta kam pas dhanë qmimin ti e din, e ke pas 850 e ke pas përpara, bane testin e paraqitjes dhe une nuk i du 20 euro edhe kurgja, F. thot 550 a, Pjetri 550 dhe të jesin e qetash herën e dyt i ki 11 euro, F. i thot 550 plus 11, ok u ka dhe kur të vendosin prindët une me të lajmru, P. thot ok më lajmron tani, ose kthemi paret e mija se qka kam shpenzua dhe shko ku të dush ti ska problem, F. i thot se une jam ka kyri ma lir me gjet, ndërsa P. i thot se ti nuk mundesh me gjet ma lir se si e kam ba unë.

Biseda e zhvilluar me dt.17.04.2011 ora 22:21:36 sek. me nr. kontaktues me nr. F. baba i F. bisedon me P. dhe i thotë se qka ka biseduar F. me ty, a mundesh pak ma lir me ba, P. i thot jo nuk ka mundësi ma lir, baba i F.

kërkon qmimin e fundit ma lir nga P<sub>1</sub>, P<sub>2</sub> i thot se qmimi i fundit është 550 dhe 11 euro për me paraqit provimin, unë me qetë formë i kry e me forma tjera nuk mundem.

Biseda e zhvilluar me dt.18.04.2011 ora 11:49:26 sek. me nr. kontaktues me nr. P<sub>1</sub> e pyet kandidatin se a është mirë puna, ndërsa kandidati i tregon P<sub>2</sub> se ka qëndruar i fundi në sall dhe është ofruar dhe i ka ndihmuar (fjala është për ekzaminerin).

Biseda e zhvilluar me dt.18.04.2011 ora 17:04:57 sek. me nr. kontaktues me nr. P<sub>1</sub> bisedon me personin NN dhe i thot se dy me i regjistruar dy tek ti dhr r pyet se a mundet me ja rregulluar kryqin e kuq, personi NN i thot se mundet dhe e pyet se a i kan edhe qertifikata e mjekut, nëse nuk i kanë le ti nxerin me dat ma të hershme, une ja kryje kryqin e kuq dhe i qet të Ejten në provim.

Biseda e zhvilluar me dt.20.04.2011 ora 12:16:24 sek. me nr. kontaktues me nr. M<sub>1</sub> bisedon në telefon me P<sub>1</sub> dhe P<sub>2</sub> i thot M<sub>1</sub> fut brenda, plotëso emrin dhe mbiemrin, mandej prit aty dhe vin të tjerët.

Biseda e zhvilluar me dt.20.04.2011 ora 17:21:03 sek. me nr. kontaktues me nr. Në këtë bised personi NN e pyet P<sub>1</sub> se si mundet me arrit një kompromis me marr lejen sepse nanen e ka të sëmur dhe nuk po mundet me msu, P<sub>2</sub> thot se duhet me paguar për këtë, dhe nëse ai nuk fiton për këtë punë duhet 250 euro nëse ka dikënd qe e dëgjon behet edhe për 200 euro po me qen së bashku brenda pa 250 euro nuk ban, për kaq me llogari me kry këtë punë pa pasur fitmi, dhe P<sub>1</sub> vazhdon dhe i thot se ti mundesh ta pyesësh ka të duash se nuk ka shanc me kry dikush ma lir.

Biseda e zhvilluar më dt.21.04.2011 ora 08:32:51 sek. me nr. kontaktues me nr. Në këtë bised telefonike P<sub>1</sub> i tregon personit NN se janë Sh<sub>1</sub>, M<sub>1</sub> dhe N<sub>1</sub> ( fjala është për rkzaminerët nga Prishtina), dhe F<sub>1</sub> e pyet se a ke dikënd, personi NN thot se e kam një që pat met qateher, nërsa e pyet P<sub>1</sub> se në sa ora e ke, personi NN i thot që e ka në ora 10:00 dhe F<sub>1</sub> i tregon se ata qetash po vin, jan nis prej knej se unë jam në Prishtin.

Biseda e zhvilluar me dt.21.04.2011 ora 12:50:05 sek. me nr. kontaktues me nr. P<sub>1</sub> bisedon me kandidatin M<sub>1</sub> dhe e pyet se a je në rregull, M<sub>1</sub> i thot jo veëm dy pyetje mi kallxoj tjerat nuk muj me të nimu, ma mur testin edhe dul edhe ati tjetrit kështu ja bani, P<sub>2</sub> e pyet se cili ke, M<sub>1</sub> i thot se njofta po ke një i vjetër me flok të bardha, F<sub>1</sub> i thot në rregull hajt se i ndreq vet ai.

Biseda e zhvilluar me dt.21.04.2011 ora 14:30:55 sek. me nr. kontaktues me nr. P<sub>1</sub> bisedon me kandidatin M<sub>1</sub> dhe kandidati i thot e mora është në rregull dhe e morëm të dy, F<sub>1</sub> i thot ri qaty se për dy minuta jam aty, dhe akndidati i thot hajt se jemi qetu duke të prit të dyt.

Biseda e zhvilluar me dt.21.04.2011 ora 14:33:19 sek. me nr. kontaktues me nr. P<sub>1</sub> bisedon në telefon me personin e quajtur B<sub>1</sub> dhe i thot a je duke ardhur mëma kryq at punë, E<sub>1</sub> e pyet P<sub>1</sub> se a e kryen L<sub>1</sub> a, P<sub>1</sub> i thot po e ka kry me sukses dhe hajde ma shpejt se ata janë duke më prit te dera.

Biseda e zhvilluar me dt.10.03.2011 ora 15:37:06 sek. me nr. kontaktues me nr. G<sub>1</sub> K<sub>1</sub> i auto shkollës " " kërkon me u taku me P<sub>1</sub> dhe lajnë takim te shtrufat në qebaptoren "Sarajeva".

Nga bisedat telefonike të të akuzuarit P. B. gjykata ka vërtetuar se i njëjti ka pasur komunikime të vazhdueshme me persona të ndryshëm në mesin e tyre edhe me kandidatët V. Veliu KK Dragash nga i cili ka marr shumën prej 400 eurove, nga kandidati F. G. nga fshati Billushë KK Prizen ka marr 350 euro, me dt.22.02.2011 nga kandidati N. Sh. ka kërkuar dhe ka marr shumën prej 500 euro, me datë 30.03.2011 nga kandidati A. i lidhur me kalimin e një kandidati kërkon 650 euro, me dt.07.04.2011 nga personi i quajtur F. i lidhur me kalimin e dy kandidatëve kërkon shumën prej 850 euro.

Sa i përket veprës penale të ushtrimit të ndikimit nga neni 345 të KPK-së, gjykata konstatoi se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer këtë veprë penale. Në të vërtetë me këtë veprë penale inkriminohet intervenimi te personi zyrtar kompetent për interes të personit të tretë.

Te kjo veprë penale bëhet fjalë për ndërmjetësim-për ndikim te personi zyrtar apo personi përgjegjës lidhur me punën nga fushëveprimi i tij zyrtar e për llogari të personit të tretë, i cili është i interesuar që një veprim i tillë të kryhet apo të mos kryhet ose është i interesuar të kryhet një punë e paligjshme apo të mos kryhet një veprim që është dashur të kryhet. Vetë ndikimi mbi personin zyrtar qëndron në shfrytëzimin e kryerësit të pozitës zyrtare a shoqërore apo ndikimi mbi një autoritet të tillë të bazuar në pozitën e kryerësit në detyrë ose në shoqëri, në parti politike etj. Gjykata konsideroi se ndikimi duhet të jetë i dukshëm përkatësisht i kundërligjshëm, ngase çdo ndikim, nuk është veprim i inkriminues respektivisht duhet të konsiderohet se është premtuar se do të kryhet një ndikim konkret për kryerjen e veprimeve konkrete nga një person zyrtar konkret ngase me këtë veprë penale inkriminohet intervenimi te personi zyrtar kompetent, e që në rastin konkret nuk është arritur të vërtetohet se i akuzuari ka ndërmarrë këto veprime inkriminuese që i vihen në bërë me akuzë.

Sa i përket veprës penale të marrjes së ryshfetit gjykata ka vërtetuar se i akuzuari është person zyrtar dhe atë në pajtim me dispozitat e nenit 107 par. 1 nënpar. 1.2 të KPK-së ku sipas kësaj dispozite mes tjerash person zyrtar konsiderohet personi i autorizuar në një organizatë biznesi, e që në rastin konkret i akuzuari P. B. ka qenë person zyrtar respektivisht instruktor në Autoshtollën " " në Prizren, e cila autoshtollë ka qenë e licencuar dhe ka vepruar si organizatë biznesi sipas leicencës me Nr. biznesi " regjistruar nga data 18.08.2010.

Në rastin konkret nuk është kontestuese dhe në tërësi është vërtetuar se i akuzuari P. B. si instruktor në Autoshtollën " " në Prizren nga kandidatë të ndryshëm të cilët i janë nënshtruar procedurës së marrjes së patent shoferit ka marrë shuma të caktuara të hollave, fakte këto të cilat janë vërtetuar nga telefonatat të cilat i njëjti i ka pasur me persona të ndryshëm në lidhje me marrjen e patentshoferit si dhe nga vetë dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar gjatë shqyrtimit kryesorë.

Sipas bindjes së gjykatës në veprimet e të akuzuarit, e në mënyrë më afër të përshkruar në shqiptimin e këtij aktgjykimi formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të marrje e ryshfetit nga neni 343 par. 1 të KPK\_së, për këtë edhe ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për këtë vepra penale, pasi që në tërësi ka gjetur se i akuzuari është juridiko penalisht përgjegjës dhe se nuk egziston asnjë rrethan e cila do të përjashtonte përgjegjësin e tij penalo juridike.

Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat gjykata këtu të akuzuarin P. B. e shpalli fajtor për veprën marrje e ryshfetit nga neni 343 par. 1 të KPK\_së dhe të njëjtit i shqiptojë dënimin, më afër të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konform nenit 64 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtin duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë. Gjykata si rrethana lehtësuese ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se i akuzuari është person familjar. Andaj, është vlerësim i gjykatës që dënimi i shqiptuar do të arrijë qëllimin e vet konform nenit 41 të KPK, se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se do të mundësoj një balancë të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale. Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar për kah lloji dhe lartësia është në harmoni me rrethanat e rastit, e nevojshme dhe të mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit konform dispozitës së lartcekur dhe se ky dënim sipas gjykatës është në harmoni dhe në baraspeshë me peshën e veprës së kryer penale dhe se kur të merret parasysh shkalla e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale, dënimi i këtillë paraqiten si të domosdoshme me qëllim të arritjes së qëllimit të dënimit, me to shprehet gjykimi i shoqërisë për shkak të veprës së kryer penale dhe forcohet obligimi i respektimit të ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u murr në mbështetje të nenit 454 par.1 dhe nenit 451 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
- Departamenti i Krimeve të Rënda-  
P.nr.206/2015 me datë 07.12.2016

Procesmbajtësja,  
Birsën Kume

Kryetari i trupit gjykues,  
Skender Çoçaj

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.